



Në bazë të nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-073923/18 dt. 28.03.2018, të shfrytëzuesit-investitorit “**Zyra e Bashkimit Evropian**” lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën përcjellëse të ndërtesës administrative me etazhitet P+0, në rrugën “Kosova”, Lagjja “Qendër” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 12.07.2019 lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit shfrytëzuesit “**Zyra e Bashkimit Evropian**”, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-073923/18 dt. 28.03.2018, për përdorimin e ndërtesës përcjellëse të ndërtesës administrative, me etazhitet P+0, e rindërtuar-ndërtuar në kuadër të parcelave kadastrale nr.05811-0, 5816-0, 5818-0 të evidentuara në certifikatat e njëjësive kadastrale P-71914059-05811-0, P-71914059-05816-0, dhe P-71914059-05818-0, Zona Kadastrale Prishtinë, Lagjja “Qendër”, në rrugën “Kosova”, Prishtinë sipas Vendimit 05 nr.351-272915 dt. 20.12.2016 për lejimin e rindërtimit-ndërtimit të ndërtesës.

II. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-272915 dt. 20.12.2016, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të Inspektimit Final, nga Inspekcioni i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës.

III. Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

IV. Kjo Certifikatë shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Shfrytëzuesi-investitori “**Zyra e Bashkimit Evropian**”, në Prishtinë, më kërkesën me 05 Nr. 391/02-0073923/18 dt. 28.03.2018, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën përcjellëse të ndërtesës administrative, me etazhitet P+0, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Vendimin nr. 05 Nr. 351-272915 dt. 20.12.2016 për lejimin e rindërtimit-ndërtimit të kompleksit të ndërtesës përcjellëse të ndërtesës administrative, me etazhitet P+0, e rindërtuar-ndërtuar në kuadër të parcelave kadastrale nr.05811-0, 5816-0, 5818-0 të evidentuara në

certifikatat e njësive kadastrale P-71914059-05811-0, P-71914059-05816-0, dhe P-71914059-05818-0, Zona Kadastrale Prishtinë, Lagjja “Qendër”, në rrugën “Kosova”, Prishtinë, me investitorin-shfrytëzuesin “**Zyra e Bashkimit Evropian**”, me seli në Prishtinë, Lagjja “Qendër” Prishtinë.

- Dispozita urbanistike e objektit me parcelën kadastrale në sistemin Kosovaref01.
- Konstatim mbi caktimin e pikave të objektit me nr. të referencës 05-945/1-0170168/17 të dt.31.07.2017.
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes,
 - Shefqet Uruqi, IDN. udhëheqës i vend ndërtimit,
 - Denis Ferizi, IDA. mbikëqyrës për arkitekturë,
 - Shefqet Uruqi IND. mbikëqyrës për Strukturë,
 - Vehbi Bresilla, IDE. Mbikëqyrës për Instalime elektrike,
 - Bujar Kryeziu, IDM. Mbikëqyrës për Instalime makinerike,
 - Kushtrim Krasniqi, gjeodet.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Sipas pikës VII. të vendimit për taksat për lëshimin e Lejes së Ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës për vitin 2013, nr. 01-016-30160 dt.12.03.2013,të Kuvendit të komunës së Prishtinës, nga lartësia e taksës administrative lirohen poseduesit e lejeve për përfaqësues diplomatik.
- Protokollet e miratuara për te gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,

Njëkohësisht nga Drejtoria e Inspektionit-Sektorit i Ndërtimit përmes shkresës-Akt përcjellës nr. 09 Nr.391/01-0079194/18 dt. 04.04.2018 ka arritur në Drejtori: Formulari i Inspektimit Final sipas UA. 05/2017 i plotësuar nga Drejtoria përkatëse, Raporti Final i inspektorëve, njoftim për punët e kryera në objekt si dhe foto të objektit të realizuar.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportin e Komisionit të Inspektimit Final të Inspektionit të ndërtimit të ndërtesës dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesave 05 Nr. 391/02-73923/18/1 dt. 27.12.2018, dhe 05 Nr. 391/02-73923/18/1 dt. 08.07.2018, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet elektrike, instalimeve makinerike dhe punëve zeytare si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen Ndërtimore 05 Nr.351-272915 dt. 20.12.2016. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa përcjellëse e ndërtesës administrative, me etazhitet P+0, mund të përdoret.

Në Raportin e Inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektorit i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në objekt janë të përfunduara. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë të aprovuara nga ana e Inspektionit të Ndërtimit.

Kërkesat e Vendimit 05 Nr. 351-272915 të datës 20.12.2015 janë zbatuar,

Faqe 2 prej 3

Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave,



Masat për kursim të energjisë janë ndërmarrë.

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesa përcjellëse e ndërtesës administrative, me etazhitet P+0, e rindërtuar-ndërtuar, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-0073923/18 DT. 12.07.2019**

Zyrtari:

Berim Osmanaj

U.D. Udhëheqëse e sektorit:

Mimoza Berisha Prestreshi

